



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2019:243111
Datë: 11.06.2024
Numri i dokumentit: 05807745

C.nr.150/19

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nderim Musa, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B..., me seli në Prishtinë, kundër të paditurit K.L., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, me objekt kontesti, khim i borxhit, jashtë seance, me datë **11.06.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET se është tërhequr padia me numër C.nr.150/19, e paditëses B..., me seli në Prishtinë, kundër të paditurit K.L., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, lidhur me çështjen kthim i borxhit.

A r s y e t i m

Paditësja ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurit për kthimin e borxhit.

Gjykata ka caktuar seancën përgatitore me datë 11.06.2024, në të cilën ka prezantuar vetëm i i padituri, ndërsa paditësja nuk ka prezantuar. Meqenëse paditësja thirrjen për seancë e kishte pranuar me rregull dhe mungesën nuk e kishte arsyetuar, kurse i padituri nuk ka propozuar që seanca të mbahet në mungesë të paditëses, gjykata padinë e paditëses e konsideroi të tërhequr.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 409 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.150/19, të datës 11.06.2024

Gjyqtari
Nderim Musa

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.